



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 5965

Prishtinë, Dt. 18/12/2024

RAPORTI I VLERESIMIT TE DORESHKRIMIT TE PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	KIMI-KIMI ORGANIKE
Projekt propozimi	Sinteza e derivative te reja te 3-[(piridin-2-ilimino)-etil]-kromen-2-oneve" dhe aktiviteti antikoagolant i tyre" "Synthesis of some new of 3-[(pyridin-2-ylimino)-ethyl]-chromen-2-one derivatives and their anticoagulant activity"
Kandidati	Rinor Bajraktari
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 13.06.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.:2077

Vlerësimi i dorëshkrimit

Lënda: Raport recenzues për vlerësim të dorëshkrimit të temës master

Këshilli i FSHMN-së i Universitetit të Prishtinës, në seancën e 83^{te} të rregullt të mbajtur më 13.06.2024 (vendimi nr. 2077) ka aprovuar projekt-propozimin për temë diplome të masterit me titull: "Sinteza e derivative te reja te 3-[(piridin-2-ilimino)-etil]-kromen-2-oneve" dhe aktiviteti antikoagolant i tyre", të kandidatit Rinor Bajraktari, ka formuar komisionin vlerësues në përbërje:

Prof. Dr. Ramiz Hoti, kryetar

Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili, anëtar

Prof. Dr. Arben Haziri, anëtar

Ndërsa si mentor është caktuar Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili

Pas kërkesës së kandidatës për vlerësimin e dorëshkrimit, Komisioni vlerësues ka analizuar

Pas kërkesës së kandidatës për vlerësimin e dorëshkrimit, Komisioni vlerësues ka analizuar dorëshkrimin e kandidatës. Pas shqyrtimit të dorëshkrimit, kemi nderin që Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore t'i paraqesim këtë:

RAPORT

Të dhënat e përgjithshme

Punimi i diplomës së masterit me titull: “**Sinteza e derivative te reja te 3-[(piridin-2-ilimino)-etil]-kromen-2-oneve” dhe aktiviteti antikoagolant i tyre**”, i kandidatit Rinor Bajraktari, Bachelor i Kimisë, është shkruar në 67 faqe. Dorëshkrimi përfshinë hyrjen, abstraktin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, pjesën teorike, metodat dhe materialet, rezultatet dhe diskutimin, përfundimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, literatura e cila përmban gjithsejt 35 të dhëna bibliografike të kohëve të fundit dhe biografinë.

Ky dorëshkrim përmban 39 figura dhe 2 tabela.

Analiza e dorëshkrimit

Fillimisht kandidati ka paraqitur një hyrje të shkurtër dhe qëllimin e këtij punimi, ku janë paraqitur arsyetimet dhe për përcaktimin në këtë fushë hulumtuese.

Në kapitullin e dytë (pjesa teorike) autori është përqendruar në rëndësinë farmaceutike që kanë këto komponime dhe derivatet e tyre, pastaj ka bërë prezantimin e publikimeve të reja nga lëmia e sintezave organike të derivateve të kumarinës..

Në kapitullin e tretë kandidati ka paraqitur metodat dhe materialet të cilat i ka përdorur për sintezën e derivateve të komponimeve. Poashtu në këtë kapitull, kandidati ka paraqitur edhe komponimet e fituar gjatë reaksioneve kimike si produkte të reja për të cilat komponime nuk ka të dhëna në literaturë. Këtu kandidati është fokusuar në llojet e reaksioneve që ka përdorur për të i përfitur këto komponime. Ai këtu tregon se ka përdorur reaksionet nën refluks, ku ka përdorur tretësa të ndryshëm organik, katalizator etj.

Kandidati gjatë punës eksperimentale ka sintetizuar këto komponime:

3-acetil-4-hidroksikumarines

3-[1-(4,6-Dimetil-piridinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksi-kromen-2-onit

3-[1-(5-klorpiridinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksi-kromen-2-onit 3-(4.6-dimetil-pirimidin-2-il)-2-(4-hidroksi-2-okso-2H-kromen-3-il)-2,5-dimetiltiazolidin- 4-onit

3-(4-klor-6-metil-pirimidin-2-il)-2-(4-hidroksi-2-okso-2Hkromen-3- il)-2,5-dimetil-tiazolidin-4-onit.

Të gjitha komponimet e sintetizuara janë fituar me rendiment te mire.

Në këtë kapitull kandidati poashtu ka paraqitur edhe aktivitetin biologjik të komponimeve të sintetizuara. Kandidati me komponimet e fituara ka trajtuar miun e llojit *Mus musculus*. Miu i trajtuar me këto substanca ka qenë me peshë nga 20-30 g dhe me moshë 1217 ditë, kjo është bërë në labororet e Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore-departamenti i Biologjisë. Trajtimi i miut me substancat e sintetizuara është bërë me metodën standarde, kurse si substance referente është përdorë Warfarina. Pas trajtimit të miut me substancat e sintetizuara është vërtetuar se këto substanca kanë aktivitet të theksuar biologjik.

Në kapitullin e katërtë, kandidati ka paraqitur në detaje sintezat e bëra. Ai ka paraqitur ekuacionet e reaksioneve, reagjentët e përdorur, katalizatorët dhe proceset e kristalizimit dhe rikristalizimit të komponimeve të sintetizuara. Në këtë kapitull autori ka paraqitur edhe tabelat e komponimeve të sintetizuara dhe efektet e këtyre komponimeve veq e veq në aspektin biologjik. Vlen të theksohet se prej komponimeve të sintetizuara efekt më të mirë biologjik, pra në kohën e koagulimit të gjakut ka treguar komponimi me numër 342. Poashtu vlen të theksohet se komponimi 342 ka qenë edhe komponimi i cili në sintezë ka qenë i fituar me rendimentin më të lartë në krahasim me komponimet tjera ku rendimenti ka qenë prej 90.88%.

Në kapitullin e 5 kandidati ka paraqitur konkluzionet lidhur me komponimet e sintetizuara. Autori këtu ka treguar jo vetëm për rëndësinë e këtyre në aspektin shkencorë hulumtues por edhe për aktivitetin e tyre biologjik.

Në kapitullin e 6 kandidati ka paraqitur Biografinë e tijë

Në kapitullin e 7 kandidati ka paraqitur literaturën e shfrytëzuar.

Vlerësim dhe propozim

Punimi i diplomës së masterit me titull: **“Sinteza e derivative të reja të 3-[(piridin-2-ilimino)-etil]-kromen-2-oneve” dhe aktiviteti antikoagolant i tyre**”, i kandidatit **Rinor Bajraktari** paraqet një kontribut për shkencën e kimisë organike hulumtuese, poashtu krijon një bazë solide që këto rezultate të fituara të gjejnë aplikim në aspektin farmaceutik. Rezultatet e këtij punimi janë origjinale dhe punimi është shkruar në mbështetje të normave për organizimin e punimit shkencorë dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret shkencore.

Në bazë të fakteve të lartëshënuara mund të konkludojmë që kandidati Rinor Bajraktari, gjatë këtij




hulumtimi shkencorë ka bërë një punë të qmueshme dhe serioze. Ky punim paraqet një kontribut shkencor në aspektin fundamental në lëminë e kimisë organike, në hulumtimin e sintezave të reja të komponimeve organike dhe mundësinë aplikimit të këtyre sintezave të reja në aspektin human për trajtim të smundjeve të ndryshme tek njerzit.

Të gjitha sygjerimet dhe vërejtjet e dhëna, me seriozitet janë pranuar nga kandidatja.

Në bazë të kësaj i propozojmë Këshillit të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës që punimin **“Sinteza e derivative të reja të 3-[(piridin-2-ilimino)-etil]-kromen-2-oneve” dhe aktiviteti antikoagolant i tyre**”, të kandidatit **Rinor Bajraktari**, t’u pranoj si bazë për arritjen e titullit shkencorë master i shkencave të kimisë- drejtimi Organik dhe ta përcjell në procedurë të mëtutjeshme.

Prishtinë, _____

Komisioni:

1. Prof. Dr. Ramiz Hoti  kryetar/
2. Prof. Asoc. Hamit Ismaili  -mentor/
3. Prof. Dr. Arben Haziri  -anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.